



Republika e Kosovës


Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për:	Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt Fatbardha Haliti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Xhevat Tafa, u. d i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 08/07/2019
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt	Nr. 020-791
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,

E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 01-020/04-0040967/19 për shfuqizimin e vendimit nr.01-020/04-008877/18 të datës 31.01.2018 për formimin e komisionit për shqyrtimi e ankesave të palëve lidhur me procedurën e dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të komunës së Skenderajt
I miratuar më datë: 28.06.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.07.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Bekim Jashari, gradonačelnik Opštine Srbica Fatbardha Haliti, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MAPL-sa Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-u.
Od:	Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Srbica
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine

Uvaženi gradonačelnice,
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 01-020/04-0040967/19 za ukidanje Odluke br. 01-020/04-008877/18 od dana, 31.01.2018. godine, za formiranje komisije za razmatranje žalbe stranaka u vezi sa procedurom davanja na kratkoročno i dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine Srbica
Usvojena dana, 28.06.2019.
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 05.07.2019.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



02-020/01-0034257/19
04.07.2019



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministria Lokale Samoprava (Administrac Ministry of Local Government Administrati			
05.07.2019			
Numri i dokumentit	Pa i Llogarit	Stanica	Vlera
-V	100	-	991

Kuvendi i Komunës/ Skupština Opštine/Municipal Assembly

Pas shqyrtimit të propozim-vendimit nr.02-020/01-0034257/19, të datës 12.06.2019, në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, qershor 2008, të nenit 14 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385, i dt.03.12.2008, të nenit 53 par.1 dhe 3, nenit 57 par.1, nenit 58 par.2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullore të mbajtur me dt.28.06.2019, mori këtë:

VENDIM

- I. Miratohet propozim - vendimi nr. 02-020/01-0034257/19 i dt.12.06.2019, për shfuqizimin e vendimit të miratuar nga Kuvendi Komunal me nr.01-020/04-0008877/18 i dt.12.02.2018, për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës.
- II. Ky shfuqizim i vendimit bëhet për arsye të ndryshimit të ligjit të mëparshëm për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr. 04/L-144, i cili me nuk është në fuqi dhe nuk prodhon efekte juridike.
- III. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën të protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

1. Arkivit
2. MAPL-së
3. Zyrës së Kryetarit
4. DGJKP-së
5. Dosjes



Kryesuesja e KK-së;
Znj. Fatbardha Haliti

[Signature]